



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-157665
Më 14.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për iniciimin e procedurës së miratimit të Draft dokumentit “Plani Lokal i Veprimit në Mjedis”, dhe mori këtë

KONKLUZION

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e iniciimit të procedurës së miratimit të “Plani Lokal i Veprimit në Mjedis”.
2. I propozohet Komitetit për Politikë dhe Financa që ta shqyrtojë këtë propozim dhe, pas shqyrtimit, atë t’ia propozojë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës.
4. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdeset: Drejtoria e Shërbimeve Publike.
5. Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KPF-ja si dhe Arkivi.
6. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-157665
Më 11.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 11 tetor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejjimit e shpalljes së tenderit për rirregullimin dhe ngjyrosjen e ulëseve, koshave për hedhurina, etj, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejjimin e rirregullimit dhe ngjyrosjen e ulëseve, koshave për hedhurina, lojërat për fëmijë, mbrojtëseve të fidanëve drunore, etj, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-161028
Më 11.11.2014



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejmimin e shitjes së automjeteve të konfiskuara të cilat gjenden në autoparkimun “Euro Ag” në Prizren, me ankand publik si dhe formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave ligjore për shitjen e këtyre automjeteve, kryetari i Komunës, më 11 nëntor 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejmimin e shitjes së automjeteve të konfiskuara nga autoritetet kompetente, të cilat gjenden në autoparkimun “Euro Ag” në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e ankand publik.
- II. Formohet dhe emërohet Komisioni për zhvillimin dhe zbatimin e procedurave ligjore të ankandit të përshkruar si në pikën I të këtij vendimi. Anëtar të këtij komisioni emërohen:
 1. Përparim Shala, kryesues i Komisionit,
 2. Asim Kokaj dhe
 3. Zekë Tejeci, anëtarë.
- III. Detyrat e Komisionit nga pika II e këtij Vendimi janë të parapara në Udhëzimin Administrativ nr. 2008/03 për procedurat e shitjes së mallrave me ankand publik dhe ë dispozitat tjera ligjor.
- IV. Komisioni, nga pika I e këtij Vendimi, do t’i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.
- V. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.
- VI. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe të emëruarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06157665
Më 11.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me 11 nëntor 2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e kanalizimit në rrugë “Nesim Krasniqi”, me participim, mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit të kanalizimit në rrugën “Nesim Krasniqi” në lagjen “UÇK”, me participim, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për realizimin e këtij projekti, do të participojë edhe komuniteti.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06157665
Më 11.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me 11 nëntor 2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin me elemente të betonit të rrugës në fshatin Pllanjan, me participim, mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndërtimit me elemente të betonit të rrugës në fshatin Pllanjan, me participim, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për realizimin e këtij projekti, do të participojë edhe komuniteti.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Drejtor, dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-157665
Më 11.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për shërbime profesionale të konsulencës, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimit e marrjes së shërbimeve profesionale të konsulencës në fushën e transaksioneve dhe projekteve me Partneritet Publiko-Privat, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-161033
Më 11.11.2014



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të tre komisioneve, kryetari i Komunës më 11 nëntor 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të tre komisioneve të formuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Prizrenit. Kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të punëve të kryera, lejohen mjetet e nevojshme financiare për kompensim të anëtarëve të komisionet si në vijim:

- a. Komisioni i Këshillit të Ekspertëve të Planifikimit,
- b. Komisioni për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve të qytetit, dhe
- c. Komisioni Komunal për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.

II. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa-Zyra e Thesarit, dhe shërbimet tjera profesionale të Komunës, që të bëj ekzekutimin e këtij vendimi duke u bazuar në vendimet përkatëse të Kuvendit të Komunës që kanë të bëjnë me formimin e këtyre komisioneve të cekura më lartë.

III. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave-Zyra e Thesarit.

V. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, Drejtorit tjera komunale, si dhe Arkivi.

VI. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-157665
Më 11.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me orendi për nevojat e zyrave që janë në riparime, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e furnizimit me orendi për nevojat e zyrave të Komunës së Prizrenit, që janë në riparime, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-157665
Më 11.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për realizimin e projektit: “Hapja dhe rregullimi i trasesë pranë bregut të Drinit të Bardhë nga ura e fshatit Gjonaj deri te ura në fshatin Nashec”, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e realizimit të projektit: “Hapja dhe rregullimi i trasesë pranë bregut të Drinit të Bardhë nga ura e fshatit Gjonaj deri te ura në fshatin Nashec”, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-161037
Më 11.11.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Durim Osmanaj, kryetari i Komunës, më 11 nëntor 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Durim Osmanaj, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit, lejohen mjetet në shumën e përgjithshme prej 300 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-157665
Më 11.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për lejimin e shpalljes së tenderit për shitjen e masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për lejimin tenderimit të masës drunore, e cila është konfiskuar nga autoritetet komunale pyjore, kështu që lejohet shpallja e ankandit publik për shitjen e 46 m³ dru të llojit ahu dhe bungu.

Shitja do të bëhet sipas specifikacionit të prezantuar të drejtorisë përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-157665
Më 11.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e shpalljes së tenderit për blerjen e një kontejneri për banim për Jovica Korolejiq, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e blerjes së një kontejneri për banim për Jovica Korolejiq, pjesëtarë i komunitetit serb, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-161043
Më 11.11.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejjimin e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të transportit të veglave dhe pajisjeve tjera, nga Hamburgu i Gjermanisë në Prizren, më 11 nëntor 2014, miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejjimin e mjeteve financiare lidhur me mbulimin e shpenzimeve të transportit (sjelljes) të veglave dhe pajisjeve tjera për nevojat e Shkollës së Mesme Teknike “11 Marsi”, nga qyteti i Hamburgut të Republikës së Gjermanisë për në qytetin e Prizrenit të Republikës së Kosovës, kështu që për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të transportit, lejohen mjetet në shumën prej 3000 €.
- II. Këto mjete-pajisje të lartcekura janë donacion për Komunën e Prizrenit nga ana e Institutit për Arsim Profesional i Hamburgut (HIBB).
- III. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin I të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- V. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, donatori si dhe arkivi.
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-157665
Më 11.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 11 nëntor 2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e shpalljes së tenderit për furnizim me dy kaldaja, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e furnizimit me dy kaldaja për ngrohje qendrore për nevojat e shkollave të Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Mjetet financiare për pagesë të dy kaldajave, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Administratës në lartësi deri në 10.000 €.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-157665
Më 11.11.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me material ndërtimor për meremetimin-ndërtimin e tri shtëpive të familjeve skamnore, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e furnizim me material ndërtimor për meremetimin-ndërtimin e tri shtëpive të familjeve skamnore të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohej shpallja e tenderit përkatës.

Përfitues të material ndërtimor për meremetimin-ndërtimin të shtëpive sipas vlerësimit të komisionit, janë:

1. Muhamet Gashi-familja e tij,
2. Bardhyl Batusha, familja e tij, dhe
3. Xhejdi Gashi-familja e tij.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja